



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 22.12.2014, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Mbledhja e konstituimit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për reformën në sistemin e drejtësisë”, me pjesëmarrjen e Kryetarit të Kuvendit, zotit Ilir Meta, i cili do të përshëndesë fillimin e punës së komisionit.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Spartak Braho dhe Ulsi Manja

Mungojnë:

Të ftuar:

Z.Nasip Naço – Ministër i Drejtësisë

Znj.Edlira Jorgaqi – Drejtore e Kodifikimit, Ministria e Drejtësisë

Z. Sokol Pasho- Drejtor i Organizimit të Pushtetit Gjyqësor, Ministria e Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Fillojmë me seancën e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi. Kjo mbledhje është hapi i parë në rrugën e një procesi të gjatë dhe pa dyshim është hapi i parë në një sfidë shumë të vështirë që ne si deputetë të këtij komisioni së bashku me kolegët tanë opozitarë, që besoj do të jenë shumë shpejt pjesë e këtij komisioni, jemi përcaktuar për ta përmbushur. Natyrisht ne jemi të ndërgjegjshëm për pritshmëritë e larta që ka publiku dhe partnerët ndërkombëtarë ndaj kësaj reforme. Kjo është një përgjegjësi e veçantë që kërkon një angazhim të veçantë të të gjithë kolegëve dhe të të gjithë atyre që do t'i atashohen këtij komisioni, në mënyrë të veçantë Ministrisë së Drejtësisë, prandaj është i pranishëm edhe vetë ministri në këtë mbledhje të parë të komisionit.

Edhe në emrin tuaj dëshiroj të vlerësoj faktin që sot në këtë mbledhje të parë të komisionit është i pranishëm Kryetari i Kuvendit, zoti Meta, dhe besoj se shpreh mendimin tuaj për ta falënderuar posaçërisht Kryetarin e Kuvendit për mbështetjen e fortë institucionale që i ka dhënë ngritjes së këtij procesi dhe vetë këtij komisioni edhe me prezencën e sotme në këtë mbledhje.

Meqenëse zoti Meta ka shprehur dëshirën për t'iu drejtuar publikut, por edhe këtij komisioni, mua nuk më mbetet gjë tjetër veçse t'i jap fjalën Kryetarit të Parlamentit.

Ilir Meta – I nderuar zoti kryetar i Komisionit të Posaçëm për Reformën në Drejtësi,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të këtij komisioni,

I nderuar zoti Ministër,

Është kënaqësi dhe për mua që të jem pjesë e fillimit të punës të këtij komisioni të posaçëm parlamentar për reformën e shumëpritur nga të gjithë në drejtësi.

Sistemi i drejtësisë është sot në fokusin, vëmendjen e të gjithëve, ndaj nisja e punës së këtij komisioni është një moment shumë i rëndësishëm që shpresojmë të jetë hapi i parë në përmbushjen e pritshmërive të larta që ekzistojnë për reformën në sistemin

e drejtësisë. Në këtë reformë mirëpresim kontributin e të gjitha forcave parlamentare, të vetë institucioneve të sistemit të organizatorëve të shoqërisë civile dhe të partnerëve tanë ndërkombëtarë. Me kënaqësi kemi konstatuar se në të gjithë tryezat e zhvilluara si nga Presidenti i Republikës, apo edhe nga ministri i Drejtësisë, si dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile, Kuvendi i Shqipërisë është identifikuar si forumi institucional më gjithëpërfshirës për kryerjen e reformës në sistemin e drejtësisë, ku fjala dhe kontributi i të gjitha palëve mund të dëgjohet me respekt dhe të merret në konsideratë. Në këtë frymë të dialogut dhe gjithëpërfshirjes do të doja të inkurajoja sot edhe partitë e opozitës që, duke zënë vendet e tyre në radhët e këtij komisioni, të përcjellin ekspertizën e tyre më të mirë dhe që së bashku me kontributin e forcave politike të shumicës parlamentare të garantohet një reformë që do të adresojë problematikën e mbartur gjatë gjithë këtyre viteve, duke gjetur zgjidhje eficiente dhe që do t'i rezistojnë kohës.

Roli i ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë të fushës së drejtësisë në funksionimin e këtij komisioni dhe në përgatitjen e produktit final të tij do të jetë, gjithashtu, mjaft i rëndësishëm. Këta ekspertë do të bëjnë të mundur që reformimi i sistemit të drejtësisë të mos ndikohet nga interesat politike të momentit, por të jetë largpamës, për t'u paraprirë sfidave të së ardhmes dhe, më kryesorja, të jetë në përputhje me parimet më të mira euroatlantike në fushën e drejtësisë.

Integrimi i Shqipërisë në BE me nisjen e punës së këtij komisioni, ka një indikator më shumë për ecurinë e tij. Analiza e gjendjes aktuale në të cilën gjendet sistemi i drejtësisë nëpërmjet kontributit të strukturave përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë dhe ekspertëve të komisionit të posaçëm parlamentar do të jetë një hap i parë i rëndësishëm i këtij procesi reformues. Pas diskutimeve, që analiza e gjendjes së sistemit të drejtësisë do të prodhojë, Kuvendi i Shqipërisë do të ketë mundësinë që me kontributin dhe konsensusin e të gjitha partive politike të miratojë një dokument strategjik për reformën në drejtësi ku të arrihet dakordësia për objektivat afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë që duhen realizuar me mbështetjen sa më të gjerë politike dhe publike.

Kuvendi i Shqipërisë do të ofrojë të gjitha mundësitë që gjatë veprimtarisë së këtij komisioni të posaçëm parlamentar ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë, që do të përfshihen, të gjitha grupet e interesit, profesionistë të fushës, opinionin publik në përgjithësi, të bëhen pjesë e diskutimeve, të kontribuojnë dhe të japin ndihmesën për të

formësuar një reformë ku të gjithë të ndihen kontributorë të një ndryshimi të domosdoshëm dhe të me të ardhme të sistemit të drejtësisë.

Faleminderit! Suksese!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Kryetar!

Shpresoj dhe besoj që ky komision, bashkë me kolegët opozitarë, që shpresojmë të gjithë të jenë shumë shpejt pjesë e Kuvendit, por edhe pjesë e këtij komisioni, ka të gjithë përgjithësinë për të përmbushur më së miri këtë detyrë të caktuar nga Kuvendi i Shqipërisë, por natyrisht këtë përgjegjësi të madhe që ka përballë publikut dhe partnerëve ndërkombëtarë edhe në kuadrin e sfidave të rëndësishme të integritetit të mëtejshëm të vendit. Natyrisht kjo është mbledhja e parë, gati një muaj pasi Kuvendi ka vendosur ngritjen e këtij komisioni, dhe natyrisht si mbledhje e parë ka disa gjëra që janë kryesisht të anës teknike. Ne do të dëshironim meqenëse ju kohën mund ta kenë. Mund të vazhdojmë? Faleminderit!

Koha në dispozicion, detyrat e përcaktuara nga Kuvendi për t'u përmbushur nga ky komision dhe nevoja që kemi për të plotësuar një sërë masash përgatitore në nisje të procesit na obligojnë që në mbledhjen e parë t'u japim rrugë disa vendimeve dhe masave të rëndësishme.

Konkretisht, Kuvendi, në pikën 2, paragrafi i parë, të vendimit të tij nr. 96/2014 datë 27.11.2014 “Për krijimin e komisionit të posaçëm parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë”, ka përcaktuar shprehimisht se:

“Komisioni i posaçëm ka për objekt të veprimtarisë së tij analizimin e gjendjes aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë me qëllim evidentimin e problematikave dhe nevojave për përmirësim në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, si dhe diskutim gjithëpërfshirës me institucionet e sistemit të drejtësisë, ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë, subjekteve të tjera të interesuara dhe opinionit publik”.

Në relacionin shoqëruar të vendimit kjo është konsideruar ndryshe dhe faza e parë e procesit të reformës. Në zbatim të këtij vendimi të Kuvendit dhe për t'i hapur rrugë kësaj faze të parë të veprimtarisë së komisionit kemi detyrimin që t'i drejtohem Ministrisë së Drejtësisë që të përgatisë dhe të prezantojë në komision një draft-dokument, i cili do të shërbejë si bazë për të nxitur diskutimin për këtë çështje.

Jemi dakord për këtë hap të parë që konturon dhe një mendim të parë? Dakord?

Faleminderit!

Hapi i dytë që mund të jetë dhe vendimi i dytë i komisionit nga pikëpamja e masave teknike dhe organizative, ka të bëjë me faktin që Kuvendi në pikën 7 paragrafi 1 dhe i 3 i vendimit të tij nr. 96/2014, datë 27.11.2014, ka përcaktuar shprehimisht se:

“Pranë komisionit të posaçëm ngrihet dhe funksionon grupi i ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë. Në përmbushje të kësaj detyre i propozoj komisionit që t’i drejtohem institucioneve kryesore sistemit të drejtësisë, të sistemit arsimor të kësaj fushe për t’u përfaqësuar në grupin e ekspertëve me ekspertët më të mirë të tyre, të cilët do të jenë pjesë e grupit të ekspertëve të nivelit të lartë”.

Konkretisht i kërkojmë Gjykatës së Lartë, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Shkollës së Magjistraturës, Universitetit të Tiranës për Fakultetin e Drejtësisë, Ministrisë së Arsimit për Komisionin Për Reformën në Arsimin e Lartë dhe Ministrisë së Drejtësisë për Komisionin e Këshillimor të Reformës Ligjore që të na dërgojnë brenda një afati, mundësisht brenda këtij viti, emrat e ekspertëve të këtyre institucioneve dhe strukturave shkencore. Nëse do të duhet që paraprakisht, përveç se do t’jua dërgojmë me shkresë, do të duhet edhe t’i kontaktojmë për t’u dhënë shpjegime. Krahas kësaj një nga kërkesat që do të duhet të adresojmë lidhet me grupet parlamentare që të gjitha grupet parlamentare, të përfshira në këtë komision të maxhorancës dhe të opozitës të dërgojnë ekspertët e tyre pjesë të këtij grupi të ekspertëve të nivelit të lartë për ta kompletuar pastaj përbërjen e plotë të grupit të ekspertëve.

Biem dakord për këtë hap? Dakord.

Faleminderit!

Hapi i tretë që është dhe vendimi i tretë i këtij komisioni, që buron, gjithashtu, nga vendimi i Kuvendit, është parashikimi që ka bërë ky vendim në pikën 7, në paragrafin 2 të tij, në të cilin është përcaktuar shprehimisht se:

“Në cilësinë e ekspertëve ndërkombëtarë komisioni do të ftojë të marrin pjesë përfaqësues të Komisionit Europian, Misionit Euralius, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, USAID-i, OPDAT-i, Këshillit të Europës, Komisionit të Venecias, prezencës së OSBE-së, si dhe misionet e asistencës për çështjet e drejtësisë së përfaqësive diplomatike në Tiranë”.

Në përmbushje të kësaj detyre i propozoj komisionit që në emër të tij të autorizohemi t'i drejtohem zyrtarisht Komisionit të Venecias, Euraliusit, Komisionit të Asistencës së BE-së, OPDAT-it dhe USAID-it, si misione asistence të SHBA-së, prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ambasadës britanike në Tiranë, fondacionit Për Shoqërinë e Hapur në Shqipëri, Soros që edhe në vlerësim të interesit tashmë të shprehur prej tyre, të na dërgojnë emrat e ekspertëve që ata mendojnë ta atashojnë si përfaqësues të tyre në përbërje të grupit të ekspertëve të nivelit të lartë.

Biem dakord me këtë gjë? Dakord.

Faleminderit!

Hapi i katërt që është dhe një vendim tjetër, që duhet ndërmarrë për organizimin e punës dhe për t'i hapur rrugë procesit ka të bëjë, gjithashtu, me pikën 7 të vendimit nr. 96, datë 27.11.2014 të Kuvendit të Shqipërisë, në të cilin është përcaktuar shprehimisht se:

“Pranë komisionit të posaçëm, në mbështetje dhe të grupit të ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë ngrihet dhe funksionon sekretariati teknik i përbërë nga këshilltarë specialistë të Shërbimit Juridik të Kuvendit, Ministrisë së Drejtësisë, juristë të institucioneve të tjera shtetërore, si dhe juristë të tjerë me përvojë që do të kontribuojnë si pjesë e kësaj strukture”. Propozoj që t'i kërkojmë Kuvendit, Ministrisë së Drejtësisë, si dhe Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, të përcaktojnë këshilltarët, specialistët që mund të jenë pjesë e këtij sekretariati.

Gjithashtu, duke vlerësuar objektin e punës së këtij komisioni, rrethin e detyrave të vështira dhe impenjative që kemi për të realizuar në një afat kohor shumë të kufizuar, dhe me qëllimin për ta bërë sa më gjithëpërfshirës këtë proces, sugjeroj që të bëjmë një thirrje publike për të gjithë ata që dëshirojnë të kontribuojnë në këtë proces duke bërë një ftesë të veçantë për të gjithë juristët e rinj të diplomuar, apo të specializuar jashtë shtetit, të cilët mund të ndihmojnë me eksperiencat e tyre ndërkombëtare, si dhe me analizat krahasuese përkatëse në këto fusha. Biem dakord që të ketë një njoftim të tillë dhe kërkesë të tillë të komisionit? Dakord?

Faleminderit!

Dhe e fundit, dëshiroj të vë në dijeni komisionin se fondacioni Për Shoqërinë e Hapur, Soros, edhe përmes drejtuesve më të lartë të tij, në vlerësim drejt qëllimit të lartë

të detyrës së këtij komisioni dhe në vazhdim të projektit të nisur prej tij për reformën kushtetuese, pjesë e programit Shteti i së Drejtës, ka shprehur vullnetin që të mbështesë veprimtarinë e këtij komisioni dhe veçanërisht punën e ekspertëve, duke bashkëmenaxhuar një sërë detyrash që lidhen me mirorganizimin e këtij procesi. Kërkohej që Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë t'i dërgojë fondacionin Soros një letër me anë të së cilës të shprehim interesin për mbështetjen që ky fondacion do të ofrojë gjatë gjithë veprimtarisë së këtij komisioni, veçanërisht për grupin e ekspertëve dhe sekretariatit teknik, si dhe kërkohej përgatitja e një draft-memorandumi bashkëpunimi midis komisionit dhe fondacionit që do të përcaktojë në mënyrë të detajuar termat e referencës së këtij bashkëpunimi. Propozojmë që në emër të këtij komisioni t'i kërkojmë sekretares së Përgjithshme të Kuvendit që, në të përmbushje të detyrës që i ka ngarkuar vendimi i Kuvendit në pikat 9,10 dhe 12 të tij, të ndërmarrë hapat e mëtejshme në këtë proces.

Biem dakord? Ka vërejte? Dakord.

Faleminderit!

Këto ishin pak a shumë propozimet për këtë mbledhje të parë të komisionit, që janë propozime kryesisht të natyrës teknike dhe organizative, për t'i hapur rrugë pastaj proceseve të mëtejshme të veprimit dhe vendimmarrjes së këtij komisioni, por natyrisht kjo shënon edhe hapjen e fazës së parë të procesit që është analiza e sistemit. Nëse ka ndonjë nga kolegët që dëshiron ta parashtrijë?

Po, zoti Braho.

Spartak Braho –Gjithmonë me merakun që edhe institucioni i Presidencës duhet të jetë prezent, mund të bëjmë ndonjë shtesë për ndonjë këshilltar nga Presidenca?

Fatmir Xhafaj – Dakord. Keni të drejtë. E ka dhe vendimi i Kuvendit. Pastaj, nëse dëshiron të përfshihet apo jo, kjo është një çështje që mbetet në vullnetin e tyre.

Dakord dhe me propozimin e zotit Braho për ta përfshirë?

Faleminderit!

Ka gjë tjetër nga kolegët? Jo nuk ka.

Atëherë le ta quajmë fillimi i mbarë gjysma e punës! Faleminderit!

Faleminderit, zoti Kryetar për prezencën tuaj!

Faleminderit, zoti Ministër!

Faleminderit, të gjithëve dhe gëzuar!

Ky është urimi i parë i bërë nga ky komision!

Gëzuar dhe mbarësi!

E mbyllim mbledhjen.